



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 27

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 2 mars 2018

PËRMBAJTJA

	Page
Vendim i Kuvendit nr. 23/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik..... 2031
Vendim i Kuvendit nr. 24/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri..... 2031
Vendim i Kuvendit nr. 25/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri..... 2031
Vendim i Kuvendit nr. 26/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri..... 2031
Vendim i Kuvendit nr. 27/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri..... 2032
Vendim i Kuvendit nr. 28/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri..... 2032
Vendim i Kuvendit nr. 29/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri..... 2032
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 23.2.2018	Për një shtesë në vendimin nr. 640, datë 7.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e sporteve të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”, të ndryshuar..... 2032
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 23.2.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 982, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në Këshillin Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit” 2033

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 100, datë 23.2.2018	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, të pronës nr. 75, me emërtim “AISM, reparti ushtarak nr. 6002”, me vendndodhje në Linzë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	2033
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 101, datë 23.2.2018	Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencive private të punësimit.....	2035
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 23.2.2018	Për lirim, mandatimin dhe rimandatimin e disa anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.....	2036
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 106, datë 23.2.2018	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së grantit nr. TF0A1769, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduar nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë, për financimin e projektit të zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (EITF).....	2037
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 23.2.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 42, datë 17.1.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, të ndryshuar”	2040
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 23.2.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 848, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.”	2041
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018	Për krijimin dhe funksionimin e fondit social.....	2041
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.2.2018	Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “profesor i asociuar” dhe “profesor”	2042
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 114, datë 23.2.2018	Për përcaktimin e rregullave për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.....	2049



VENDIM
Nr. 23/2018

**PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Evis Shurdha zgjidhet kryetare e Komisionit të Prokurimit Publik.
- II. Mandati i kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik është 5-vjeçar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 26.2.2018

VENDIM
Nr. 24/2018

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
BORDIT TË INSTITUTIT TË
STUDIMEVE PËR KRIMET DHE
PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 18, të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Institutit të Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Gëzim Peshkëpia zgjidhet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 26.2.2018

VENDIM
Nr. 25/2018

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI
TË BORDIT TË INSTITUTIT TË
STUDIMEVE PËR KRIMET DHE
PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 18, të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Institutit të Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Etleva Shehu zgjidhet anëtare e Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 26.2.2018

VENDIM
Nr. 26/2018

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI
TË BORDIT TË INSTITUTIT TË
STUDIMEVE PËR KRIMET DHE
PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 18, të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e shoqërisë civile,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Jonida Godolja zgjidhet anëtare e Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 26.2.2018



VENDIM
Nr. 27/2018

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI
TË BORDIT TË INSTITUTIT TË
STUDIMEVE PËR KRIMET DHE
PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 18, të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Akademisë së Shkencave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Vasil Tole zgjidhet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 26.2.2018

VENDIM
Nr. 28/2018

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI
TË BORDIT TË INSTITUTIT TË
STUDIMEVE PËR KRIMET DHE
PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 18, të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Rektorëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Enriketa Pandelejmoni zgjidhet anëtare e Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 26.2.2018

VENDIM
Nr. 29/2018

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI
TË BORDIT TË INSTITUTIT TË
STUDIMEVE PËR KRIMET DHE
PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 18, të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Rektorëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Kolec Topalli zgjidhet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 26.2.2018

VENDIM
Nr. 98, datë 23.2.2018

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 640, DATË 7.9.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E
SPORTELEVE TË FONDIT TË
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË
ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË
OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE
TË INTEGRUARA (ADISA)”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 50, të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 1, të vendimit nr. 640, datë 7.9.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar,



pas fjalës “... Gjirokastër ...” shtohen fjalët “... dhe Shkodër ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 99, datë 23.2.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 982, DATË 25.10.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr. 982, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si më poshtë vijon:

- Z. Artan Shkreli, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë;

- Znj. Albana Shkurta, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë;

- Z. Hajrulla Çeku, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit;

- Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal (AZHER).”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 100, datë 23.2.2018

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA TIRANË, TË PRONËS NR. 75, ME EMËRTIM “AISM, REPARTI USHTARAK NR. 6002”, ME VENDNDODHJE NË LINZË, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, të pronës nr. 75, me emërtim “AISM, reparti ushtarak nr. 6002”, me vendndodhje në Linzë, Tiranë, sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e një shkolle të re.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 75, me emërtim “AISM, reparti ushtarak nr. 6002”, me vendndodhje në Linzë, Tiranë, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Tiranë.


3. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.



4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Tiranë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama





VENDIM
Nr. 101, datë 23.2.2018

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË
FUNKSIONIMIT TË AGJENCIVE
PRIVATE TË PUNËSIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Veprimtaria private e ndërmjetësimit në punë të ushtrohet vetëm nga agjencitë private të punësimit (në vijim, agjencia), të licencuara, pas përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për licencat, në përputhje me parashikimin e pikës 3, të këtij vendimi.

2. Agjencia private e punësimit regjistrohet si person fizik/juridik, privat dhe e ushtron veprimtarinë e ndërmjetësimit në punë, nëpërmjet këtyre shërbimeve:

a) Informimit, këshillimit, si dhe vlerësimit të kërkesave e të aplikimeve për ndërmjetësim për punësim;

b) Kërkimit të vendeve të punës;

c) Ndërmjetësimit për përcaktimin e kushteve dhe të lidhjeve e të marrëdhënieve të punës, ndërmjet punëkërkuësit dhe punëdhënësit.

3. Për të ushtruar aktivitetin e saj, agjencia duhet të pajiset me licencën e kategorisë X.2.A, “Ndërmjetësim në tregun e punës”, në zbatim të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave”, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta”.

4. Për punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë shtetit, agjencia zbaton të gjitha marrëveshjet dypalëshe të qeverisë shqiptare me vendet përkatëse.

5. Shërbimet e agjencisë për punëkërkuësit janë falas. Agjencia nuk e ngarkon punëkërkuësin me asnjë detyrim financiar, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me përjashtim të pagesës së shpenzimeve të nevojshme për plotësimin e dosjes administrative të çdo punëkërkuësi.

6. Shpenzimet për shërbimin e ndërmjetësimit,

të kryer nga agjencia, të përballohen nga pala punëdhënëse.

7. Agjencia siguron trajtim të barabartë për të gjithë punëkërkuësit.

8. Punëkërkuësi i ndërmjetësuar në punë nga agjencia gëzon të drejtën për negociimin kolektiv, pagën minimale, kohën dhe kushtet e punës, përfitimet e sigurimeve shoqërore, mbrojtjen e pasurisë dhe të shëndetit në punë.

9. Agjencia duhet të njoftojë punëkërkuësin për kushtet e punës dhe të punësimit, përpara fillimit të marrëdhënieve të punës.

10. Agjencia nuk duhet të ndërmjetësojë për punëkërkuësin në vende pune, që paraqesin rrezik e pasiguri për jetën dhe shëndetin e tij apo ku mund të jetë subjekt abuzimi apo trajtimi diskriminues.

11. Personeli i agjencisë, për shërbimet që ofron, duhet të ketë kualifikimin dhe trajnimin e nevojshëm.

12. Agjencia bashkëpunon me zyrat shtetërore të punësimit për:

a) mbledhjen, shkëmbimin e të dhënave dhe përdorimin e terminologjisë së përbashkët, për përmirësimin e transparencës së funksionimit të tregut të punës;

b) shkëmbimin e njoftimeve për vendet e lira të punës;

c) lidhjen e marrëveshjeve për zbatimin e veprimtarive të ndryshme;

ç) trajnimin e stafit.

13. Në rastet kur agjencia/personi fizik/juridik (ortaku, aksionari apo anëtari i organeve drejtuese të tij):

a) ka qenë i dënuar për vepra penale të kryera me dashje;

b) ka shkelur parimin e barazisë, duke diskriminuar punëkërkuësin;

c) provohet se ka kërkuar tarifa nga punëkërkuësi për shërbimet e ofruara drejtpërdrejt apo tërthorazi ose ka pranuar pagesa, mallra apo shërbime nga punëkërkuësi, përveç pagesës së parashikuar në pikën 5, të këtij vendimi;

ç) reklamon njoftime të rreme ose mashtruese për ndërmjetësimin;

d) bën deklarata, dëshmi të rreme ose përdor dokumente të falsifikuara;

dh) nxit drejtpërdrejt apo tërthorazi punëkërkuësin për t’u transferuar në një vend tjetër pune, përveç rastit kur transferimi është në interes të punëkërkuësit;



e) ndikon ose përpiket të ndikojë çdo punëdhënës ose ndërmarrje për të mos punësuar disa persona;

ë) ofron shërbimet e veta për të miturit;

f) angazhohet të ndërmjetësojë për punëkërkesin në vende pune, që cenojnë dinjitetin e Republikës së Shqipërisë;

g) pengon ose përpiket të pengojë inspektimin e organeve përkatëse;

gj) nuk përmbush detyrimet për sigurimet shoqërore apo kontratat e punës për punëmarrësit e vet;

h) nuk respekton dispozitat e këtij vendimi,

ministra përgjegjëse për çështjet e punësimit njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për revokimin e licencës, sipas akteve të përmendura në pikën 3, të këtij vendimi.

14. Përpunimi i të dhënave të punëkërkesit nga agjencia bëhet duke respektuar konfidencialitetin dhe përdorimin e të dhënave, sipas natyrës së punës dhe nuk përhapet për asnjë lloj tjetër qëllimi, përveç atij për të cilin janë dhënë, duke përjashtuar rastet kur është dhënë pëlqimi me shkrim nga personi që e jep informacionin.

15. Agjencia nuk duhet të regjistrojë në dosje apo regjistra të dhëna vetjake të punëkërkesit, që nuk janë të nevojshme për të vlerësuar prirjen e tij për vendin e punës.

16. Agjencia duhet t'i ruajë të dhënat vetjake të një punëkërkesi, vetëm për atë kohë sa justifikohet nga qëllimet e veçanta, për të cilat janë mbledhur këto të dhëna apo, për atë kohë sa punëkërkesi dëshiron të mbetet në listën e kandidatëve të mundshëm për një vend pune.

17. Agjencia, përveç rasteve kur lidhet drejtpërdrejt me kërkesat për një profesion të veçantë apo me pëlqimin e punëkërkesit të interesuar, nuk duhet të kërkojë, të ruajë apo të përdorë të dhëna për gjendjen mjekësore të një punëkërkesi ose të përdorë një të dhënë të tillë për përcaktimin e përshtatshmërisë së tij për punësim.

18. Inspektorati Shtetëror i Punës kryen inspektime periodike për të përcaktuar përputhshmërinë e veprimtarisë së agjencisë me legjislacionin përkatës dhe, kur vëren shkelje, njofton ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit.

19. Vendimi nr. 708, datë 16.10.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e licencimit dhe të funksionimit të agjencive private të punësimit”, shfuqizohet.

20. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Inspektorati Shtetëror i Punës, Qendra Kombëtare e Biznesit dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 102, datë 23.2.2018

**PËR LIRIMIN, MANDATIMIN DHE
RIMANDATIMIN E DISA ANËTARËVE
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
KONTABILITETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lirimin nga funksioni, për shkak të përfundimit të mandatit, të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, si më poshtë vijon:

- a) Z. Fran Brahim;
- b) Znj. Anila Çili;
- c) Z. Agim Binaj;
- ç) Znj. Vjollca Karapici.

2. Mandatimin, si anëtarë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të:

a) Znj. Edlira Luçi, propozuar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë;

b) Znj. Greta Angjeli, propozuar nga organizatat e profesioneve të lira.

3. Rimandatimin, si anëtar të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të z. Fran Brahim, propozuar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 106, datë 23.2.2018

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
 NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË
 GRANTIT NR. TF0A1769, NDËRMJET
 REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
 BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
 RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË
 VEPRON SI ADMINISTRATORE E
 FONDEVE TË GRANTIT TË AKORDUAR
 NGA FONDI I MIRËBESIMIT ME
 SHUMË DONATORË, PËR FINANCIMIN
 E PROJEKTIT TË ZBATIMIT TË NISMËS
 PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË
 NXJERRËSE NË SHQIPËRI (EITI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së grantit nr. TF0A1769, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduar nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë, për financimin e projektit të zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (EITI), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

BANKA BOTËRORE
IBRD.IDA/GRUP I BANKËS BOTËRORE

17 nëntor 2017

Sh.t. z. Arben Ahmetaj
 Ministër i Financave dhe Ekonomisë
 Ministria e Financave dhe Ekonomisë
 Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
 Tiranë
 Republika e Shqipërisë

**Granti nr. TF0A1769 – Granti EGPS për
 Financimin e Projektit të Zbatimit të Nismës
 për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse
 Amendimi nr. 1 i Letërmarrëveshjes**

Ne i referohemi Letërmarrëveshjes (Marrëveshja) së datës 26 shkurt 2016 për zbatimin e Financimit e Projektit të Zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (Projekti) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), sipas të cilës Banka Botërore ka dhënë Grantin e sipërpërmendur (Granti). Ne, gjithashtu, i referohemi letres suaj të datës 26 prill 2017, në të cilën është kërkuar financim shtesë për aktivitete të reja dhe zgjatjen e afatit të Datës së Mbylljes së Grantit. Ju lutem, vini re që termat me germa të mëdha në këtë letër (Letër Amendimi) dhe që nuk janë përcaktuar ndryshe këtu, mbeten siç janë përcaktuar në Marrëveshje.

Duke pasur parasysh sa më sipër dhe diskutimet tona të fundit, Banka Botërore propozon të amendojë Marrëveshjen si vijon (Amendimi).

1. Paragrafi i parë i Marrëveshjes në këtë mënyrë amendohet dhe ndryshohet në tërësi për t’u lexuar si vijon:

“Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të bërë në emër të Republikës së Shqipërisë (Marrësi), kam kënaqësinë t’ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), në cilësinë e administratorit të fondeve të grantit të dhënë nga Federata e Australisë, Kanadaja, Republika e Finlandës, Republika Federale e Gjermanisë, Mbretëria e Norvegjisë, Zvicra dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlanda e Veriut (Donatorët), në bazë të Mbështetjes Programatike Globale për Industrinë Nxjerrëse (EGPS) të Fondit të Besimit me Shumë Donatorë (TF072347),



propozon t'i japë Marrësit një grant në shumën që nuk tejkalon një milion dollarë amerikanë (1,000,000 US \$) (Granti), sipas termave dhe kushteve të përcaktuar ose të përmendur në këtë Letërmarrëveshje (Marrëveshja), e cila përfshin shtojcën bashkëlidhur, për të asistuar me financimin e Projektit të përshkruar në shtojcë (Projekti).”.

2. Paragrafi “b”, i seksionit 1.02, të shtojcës së Marrëveshjes, në këtë mënyrë, ndryshohet dhe amendohet në tërësi për t'u lexuar si më poshtë:

“b) “EITP” nënkupton Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, standardin global për miradministrimin e naftës, gazit dhe burimeve minerare.”.

3. Janë shtuar dy përcaktime të reja, në rend alfabetik, në seksionin 1.02 të shtojcës së Marrëveshjes dhe të gjithë paragrafët në vijim rinumërohen në përputhje me të:

“Standardi EITP” nënkupton kërkesat e zbatueshme nga vendet që zbatojnë EITI-n dhe Statutit që rregullon Shoqatën EITI, të publikuara nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI, në datën 23 shkurt 2016.”.

“Informacion për Pronësinë Reale/Përfituese” nënkupton informacionin në lidhje me naftën, gazin dhe shoqëritë minerare të cilat ofertojnë për, operojnë ose investojnë në projektet për industrinë nxjerrëse të një vendi, për personin ose persona fizikë, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë zotërojnë ose kontrollojnë ekonominë e Entit/Subjektit.”.

4. Seksioni 2.01 i shtojcës së Marrëveshjes është amenduar dhe zëvendësuar në tërësinë e tij për t'u lexuar si më poshtë:

“2.01. Objektivat e Projektit dhe Përshkrimi. Objektivi i Projektit është asistimi i Marrësit në zbatimin e Agjendës së tij EITI. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa A. Mbështetja për zbatimin e EITI-t

Mbështetje për Marrësin, për të arritur dhe për të ruajtur detyrimet për statusin si Vendzbatues i EITI-t, duke përfshirë dhe përmes rekrutimit, të: i) një administratori të pavarur për të mbikëqyrur përgatitjen e raporteve vjetore EITI që mbulojnë të gjitha industritë nxjerrëse për vitet kalendarike 2015, 2016 dhe 2017; ii) një ekspert ligjor për të realizuar një raport kërkimor ligjor dhe rregullator për identifikimin e faktorëve që sjellin ngadalësimin e mbledhjes së të dhënave në përgatitjen e

Raporteve EITI, si dhe të rekomandojë përmirësime; dhe iii) shërbime konsulence për të mbështetur zbatimin e rekomandimeve nga raportet EITI.

Pjesa B. Trajnimet

Sigurimi i asistencës teknike dhe trajnimeve thelbësore mbi EITI-n dhe menaxhimin e burimeve natyrore, nëpërmjet: i) realizimit të trajnimeve të përshtatura për të gjitha palët e interesit të përfshira në industrinë nxjerrëse, duke përfshirë Sekretariatit Kombëtar EITI dhe MSG-në, organizatat e shoqërisë civile për çështje të lidhura me industrinë nxjerrëse, standardin EITI dhe transparencën në përgjithësi në këtë sektor; ii) ofrimin e shërbimeve këshillimore teknike për agjencitë shtetërore dhe shoqëritë që operojnë në industrinë nxjerrëse për trajtimin e nevojave të tyre të veçanta në përshtatje me kërkesat raportuese të EITI-t; dhe iii) pjesëmarrjes së palëve të zgjedhura në forume ndërkombëtare për Informacionin e Pronësisë Reale/Përfituese dhe qeverisjen/administrimin e burimeve natyrore.

Pjesa C. Komunikimi dhe Informimi

Mbështetje e strategjisë së komunikimit për zbatimin e EITI-t për vitin e parë të zbatimit të projektit, duke përfshirë: i) mbështetje për printimin dhe fushatat e mediave vizive për mbështetjen e Sekretariatit Kombëtar EITI për të publikuar dhe për të shpërndarë informacion kritik të publiku; ii) rritjen e ndërgjegjësimit nëpërmjet organizimit të eventeve që përfshijnë konferenca shtypi dhe seminare për të kuptuar çështjet kyçe në lidhje me industrinë nxjerrëse; iii) menaxhimin e faqes së internetit të EITI Albania, si dhe llogarive të mediave sociale; dhe iv) rekrutimin e një ambasadori të marrëdhënieve me publikun EITI për vitin 2018.

Pjesa D. Menaxhimi i Projektit

Fuqizimi i kapacitetit të Sekretariatit Kombëtar EITI për të zbatuar menaxhimin e Projektit nëpërmjet: i) rekrutimit të shërbimeve të një specialisti TI-je dhe një specialisti prokurimi me anë të kontratave; ii) financimi i Kostove Operative.

Pjesa E. Procedurat e Mbledhjes së të Dhënave dhe Portali i të Dhënave të Hapura

Ofrimi i mbështetjes për përmirësimin e aksesit në të dhënat EITI, nëpërmjet: i) vlerësimit të pengesave në aksesin e të dhënave në territorin e Marrësit, duke përfshirë përgatitjen e një plani veprimi për trajtimin e boshllëqeve rregullatore,



gatishmërinë e subjekteve raportuese dhe institucioneve publike dhe çështjet e mbledhjes së të dhënave; dhe ii) përgatitjen e një udhërrëfyese për krijimin e një portali me të dhëna transparente për të dhënat EITI.

Pjesa F. Bërja Publike e Informacionit për Përfituesit Realë

Ofrimi i mbështetjes për zbatimin e kërkesave të Standardit EITI në bërjen publike të Informacionit

për Përfituesit Realë, nëpërmjet: i) aktiviteteve këshilluese me palët kyçe të interesuara; ii) ndërtimi i konsensusit ndërmjet palëve kyçe të interesuara, duke përfshirë ndryshimet e kërkuara në kuadrin ligjor ekzistues; dhe iii) zbatimin e rekomandimeve të shprehura në pjesën A (ii) të Projektit.”

5. Tabela nën seksionin 3.01 e aneksit të Marrëveshjes është amenduar dhe zëvendësuar në tërësinë e saj, për t'u lexuar si më poshtë:

Kategoria	Shuma e Alokuar e Grantit (e shprehur në dollarë amerikanë)	Përqindja e Shpenzimeve për t'u Financuar (përfshirë taksat)
1. Mallra, Shërbime konsulence, Trajnime dhe Kosto Operative të Projektit	1,000,000	100 %
Shuma totale	1,000,000	

6. Seksioni 3.03 i shtojcës së Marrëveshjes është amenduar dhe zëvendësuar në tërësinë e tij, për t'u lexuar si më poshtë:

“3.03 Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes e përmendur në seksionin 3.06 (c) të Kushteve Standarde është 31 dhjetor 2018.”

7. Seksioni 4.01 i shtojcës së Marrëveshjes është amenduar dhe zëvendësuar në tërësinë e tij, për t'u lexuar si më poshtë :

“4.01 Përfaqësuesi i Marrësit. Përfaqësuesi i Marrësit, i përmendur në seksionin 7.02 të Kushteve Standarde, është Ministri i Financave dhe Ekonomisë.”

8. Seksioni 4.02 i Shtojcës së Marrëveshjes është amenduar dhe zëvendësuar në tërësinë e tij për t'u lexuar si më poshtë :

“4.02 Adresa e Marrësit. Adresa e Marrësit, e përmendur në seksionin 7.01 të Kushteve Standarde, është:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Faksimile: +355 4 222 8405.”

Të gjithë termat dhe kushtet e Marrëveshjes, përveç atyre të amenduar nëpërmjet kësaj Letre Amendimi, do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Ju lutem, konfirmoni Marrëveshjen e Marrësit me Amendimin e mësipërm, duke nënshkruar, duke vendosur datën dhe duke e kthyer te ne kopjen bashkëlidhur të kësaj Letre Amendimi. Kjo Letër Amendimi do të bëhet efektive nga data në të cilën Banka Botërore dërgon te Marrësi njoftimin

për marrjen e njoftimit të Marrësit mbi mbylljen e procedurave të brendshme, të nevojshme për hyrjen e tij në fuqi sipas legjislacionit të Marrësit.

Me respekt,
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim
Maryam Salim
Menaxhere Vendi
Zyra e Bankës Botërore
Republika e Shqipërisë

MIRATUAR:

Republika e Shqipërisë

Nga: _____

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: Arben Ahmetaj

Pozicioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Data 10.1.2018



VENDIM
Nr. 107, datë 23.2.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 42, DATË 17.1.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të nenit 18, të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 42, datë 17.1.1998, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Neni 12 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 12

Këshilli administrativ trepalësh është organi më i lartë vendimmarrës i Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Ai përbëhet nga 11 anëtarë dhe kryesohet nga ministri përgjegjës për çështjet e punësimit. Anëtarë të tjerë të këshillit janë, si më poshtë vijon:

- 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;
- 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- 1 përfaqësues nga Inspektorati Shtetëror i Punës;
- 1 përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- 1 përfaqësues nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- 2 përfaqësues nga organizatat më të përfaqësuara të punëmarrësve;
- 2 përfaqësues nga organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve.

Mandati i anëtarëve të këshillit është trevjeçar dhe miratimi i tyre, pas propozimit nga institucionet/organizatat e sipërpërmendura, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit. Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore duhet të jenë në nivel zëvendësministri ose

nëpunës të kategorisë së lartë drejtuese. Shpërblimi për pjesëmarrjen në mbledhjet e këshillit bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Këshilli e ushtron veprimtarinë e tij sipas rregullores së funksionimit të tij.”

2. Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

Këshilli mbledhet, të paktën, 4 (katër) herë në vit. Mbledhja e këshillit thirret dhe drejtohet nga kryetari i këshillit administrativ, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të SHKP-së.

Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit por, në çdo rast, duhet të jenë të pranishëm, të paktën, 1 (një) anëtar, përfaqësues i organizatave të punëdhënësve dhe 1 (një) anëtar, përfaqësues i organizatave të punëmarrësve. Vendimet e këshillit administrativ trepalësh nënshkruhen nga kryetari i këshillit.

Mbledhja e këshillit administrativ trepalësh dokumentohet nga sekretariati.”

3. Neni 23 ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 23

SHKP-ja bashkëpunon me institucione të ndryshme shtetërore si edhe me organizata joqeveritare, shqiptare apo të huaja, që kryejnë veprimtari në fushën e punësimit ose në fusha të ngjashme me të dhe mund të lidhë marrëveshje, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

4. Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” dhe “Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” zëvendësohen me fjalët “... ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit ...” dhe “... ministri përgjegjës për çështjet e punësimit ...”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM

Nr. 108, datë 23.2.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 848, DATË 7.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA DHE PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT PUBLIK, QË PËRFAQËSON SHETËTIN SI PRONAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE “ALBPETROL” SHA DHE “ALBGAZ” SHA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 36, pikat 2 e 5; 50, pikat 2 e 4, 57 e 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimin nr. 848, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, riformulohet, si më poshtë:

“3. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë “Albgaz” sh.a., është ministria përgjegjëse për infrastrukturën.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe shoqëria “Albgaz” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 111, datë 23.2.2018

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E FONDIT SOCIAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe të pikës 4, të nenit 47, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e fondit social të mekanizmit financiar, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, planifikimin e krijimit e shërbimeve të reja, si dhe zhvillimin e politikave sociale.

2. Fondi social krijohet me burime financiare, nga:

a) fondet e kushtëzuara që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;

b) fondet nga buxhetet e njërive të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore;

c) të ardhurat nga organizatat jofitimprurëse, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë;

ç) tarifatat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

3. Mekanizmi i financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror ndjek hapat e përcaktuar më poshtë, në përputhje me ciklin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm.

4. Programimi dhe financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

4.1. Njësia e vetëqeverisjes vendore vlerëson nevojat për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor, në përputhje me planin strategjik të zhvillimit dhe me programin buxhetor afatmesëm.

4.2. Njësia e vetëqeverisjes vendore vlerëson kapacitetet financiare dhe burimet njerëzore që mbështesin ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor. Deri në miratimin e standardeve kombëtare, bashkitë duhet të marrin



në konsideratë që të vazhdojnë ofrimin e të paktën atyre shërbimeve që kanë ofruar gjatë tri viteve të fundit.

4.3. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon në buxhetin e saj fonde për financimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, të cilat u transferohen njësisë të vetëqeverisjes vendore ku funksionojnë këto shërbime, bazuar në planet sociale të buxhetuara.

5. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

5.1. Të gjitha shërbimet e përkujdesjes shoqërore, të parashikuara në kreun II, të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror, të cilat konsiderohen si parësore nga bashkia, por që nuk mund të ofrohen prej saj, mund të ofrohen nga organizata jofitimprurëse, si ndërmarrje sociale apo struktura të ngjashme me to, që operojnë në këtë fushë private.

5.2. Njësia e vetëqeverisjes vendore prokuron shërbimet e kujdesit shoqëror dhe lidh kontratat me ofruesit e shërbimit, duke u dhënë përparësi ndërmarrjeve sociale në ofrimin e këtyre shërbimeve.

5.3. Ofruesit privatë, të kontraktuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat jofitimprurëse, ofrojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, si pjesë e kontratës ose e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet palëve.

6. Monitorimi dhe raportimi për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror

6.1. Njësia e vetëqeverisjes vendore raporton, çdo katër muaj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, financiar me anë të fondit social, pranë Shërbimit Social Shtetëror.

6.2. Inspektorati që mbulon fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e parashikuara në nenin 35, të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror, siguron zbatueshmërinë e standardeve të shërbimeve shoqërore të orfuar nga subjektet e kontraktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

6.3. Njësia e vetëqeverisjes vendore, paralelisht, monitoron ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas standardeve e treguesve të performancës, përcaktuar në marrëveshjen kontraktuale me nënkontratorët privatë dhe sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse.

7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme,

nëpërmjet njësisë të vetëqeverisjes vendore, dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 112, datë 23.2.2018

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR” DHE TË STANDARDEVE SHTETËRORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË “PROFESOR I ASOCIUAR” DHE “PROFESOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 60, pika 3, e 79, pika 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

KRITERET PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”

1. Studimet për gradën shkencore “doktor” zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur, në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, pranë institucioneve të arsimit të lartë të llojit “universitet” ose “akademi”, të cilat plotësojnë kriteret ligjore dhe ato të përcaktuara në këtë vendim.

2. Grada shkencore “doktor” fitohet pas mbrojtjes me sukses të tezës së disertacionit, në përfundim të studimeve të doktoratës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, sipas kriterëve dhe brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

3. Studimet e doktoratës zhvillohen në formën e grupeve kërkimore, që drejtohen nga personeli



akademik, që ka titullin akademik “profesor i asociuar” ose “profesor”. Numri i doktorantëve në përbërje të secilit grup kërkimor, i cili përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar, është:

a) jo më shumë se 7 (shtatë), në rastin e personelit akademik që mban titullin “profesor”;

b) jo më shumë se 5 (pesë), në rastin e personelit akademik që mban titullin “profesor i asociuar”;

c) jo më shumë se 3 (tre), në rastin kur personeli akademik, që ka titullin akademik “profesor i asociuar” ose “profesor”, është i angazhuar me kohë të pjesshme.

4. Kandidati aplikon individualisht në programin e studimit të miratuar në fushat e kërkimit shkencor, të ofruara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Njësia bazë miraton programet individuale të kërkimit të kandidatëve vetëm për ato fusha, të cilat u përkasin programeve të miratuara të doktoratës që ajo ofron. Kur fushat e kërkimit janë të ndërthurura ndërmjet dy ose më shumë njësive bazë, njëra prej njësive bazë caktohet përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakordësi ndërmjet tyre.

5. Njësia kryesore, në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve, përcakton kriteret specifike:

a) që kandidati duhet të plotësojë për t’u pranuar apo për të transferuar studimet në programin e studimit, sipas fushës së kërkimit;

b) për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor gjatë periudhës së studimeve të doktoratës;

c) që kandidati duhet të plotësojë përpara mbrojtjes përfundimtare të tezës së disertacionit;

ç) kur studimet e doktoratës ndërpriten, shtyhen ose pezullohen;

d) për afatet e pagesës për të gjithë ciklin e programit.

6. Kriteret bazë, që duhet të plotësojë kandidati përpara mbrojtjes së disertacionit, janë:

a) Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi

paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;

b) Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 2 (dy) të jenë botuar ose pranuar për botim në revista të indeksuara të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës, me bord editorial, ku, së paku, në njërin prej tyre të jetë autor i parë dhe në tjetrin autor i dytë.

7. Kandidati harton disertacionin sipas formatit të miratuar në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve. Disertacioni duhet të sjellë risi teorike dhe/ose empirike në fushën përkatëse të kërkimit, si dhe të jetë një kontribut në avancimin e njohurive shkencore. Disertacioni hartohet në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje e tij (2000–4000 fjalë) në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, në format të shtypur dhe elektronik. Disertacioni miratohet nga udhëheqësi shkencor përpara dorëzimit.

8. Kandidati dorëzon disertacionin, siç përcaktohet në pikën 7 të këtij kreu, së bashku me dosjen, pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit. Pas vlerësimit nga njësia bazë, disertacioni dhe dosja e kandidatit i përcillen Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit. Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj. Disertacioni prezantohet para jurisë, e cila e vlerëson atë. Juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, i cili, brenda 10 (dhjetë) ditëve, merr vendimin për dhënien e gradës shkencore “doktor” dhe ia përcjell për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore.

9. Nëse njësia bazë jep vlerësim negativ për disertacionin dhe/ose dosjen, kandidati ka të drejtë të riparaqesë disertacionin dhe/ose dosjen të plotësuar pas një periudhe jo më të shkurtër se 3 (tre) muaj.

10. Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, i cili monitoron procesin për dhënien e gradës shkencore “doktor”, përbëhet nga jo më



pak se 5 (pesë) anëtarë të zgjedhur të njësisë kryesore ku ofrohet programi i doktoratës, që kanë titullin akademik “profesor i asociuar” ose “profesor”.

11. Juria për mbrojtjen e gradës shkencore “doktor” ngrihet nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” dhe ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët, të paktën 2 (dy) anëtarë u përkasin njësisë bazë nga institucione homologe, vendëse ose të huaja. Dy anëtarë të jurisë caktohen opONENTË për vlerësimin e disertacionit, njëri prej të cilëve i përket njësisë bazë nga institucione homologe, vendëse ose të huaja. Anëtarët e jurisë propozohen nga njësi bazë, me miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore. Numri i anëtarëve të propozuar është jo më pak se 8 (tetë).

12. Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë përcillet nga institucioni i arsimit të lartë në ministrinë përgjegjëse për arsimin, për t’u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore e titujve akademikë dhe në regjistrat përkatës të IAL-së. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë për dhënien e gradës shkencore “doktor”, e nënshkruar nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe rektori.

13. Procedura më të detajuara për fitimin e gradës shkencore “doktor” përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë (IAL) dhe rregulloren e ciklit të tretë të studimeve, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.

KREU II

STANDARDET PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK “PROFESOR I ASOCIUAR”

1. Titulli akademik “profesor i asociuar” jepet nga institucionet e arsimit të lartë, të llojit “Universitet”, të cilat plotësojnë kriteret ligjore dhe ato të përcaktuara në këtë vendim.

2. Aplikimet për fitimin e titullit akademik “profesor i asociuar” kryhen nga anëtarët e personelit akademik të kategorisë “Lektor”.

3. Personeli akademik i kategorisë “lektor” aplikon për fitimin e titullit akademik “profesor i asociuar” të paktën 5 (pesë) vjet, nga data që ka mbrojtur gradën shkencore “doktor”.

4. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin “profesor i asociuar”, duhet:

a) të ketë zhvilluar një cikël të plotë leksionesh për, së paku, një lëndë, për 3 (tri) vite akademike;

b) të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5-vjeçare (pesëvjeçare), me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor, për një periudhë 8-vjeçare (tetëvjeçare) akademike, me apo pa ndërprerje, pas fitimit të gradës shkencore “doktor”;

c) të jetë i aftë të mbajë leksione në një pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojtë veprimtarinë kërkimore botuese përpara Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në një nga gjuhët e mësipërme, në përputhje me statutin dhe rregulloren e IAL-së.

5. Personeli akademik, që aplikon për titullin “profesor i asociuar”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:

a) Ka botuar, së paku, 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 2 (dy) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga *Thomson Reuters* dhe/ose *Scopus*. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autori i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në, të paktën, 2 (dy) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;

b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku, 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

6. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:

a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “doktor”, brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësi bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSE*



Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës.

b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:

i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;

ii) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:

i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;

ii) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

7. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore “doktor”, në:

a) komitete shkencore apo redaktuese;

b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;

c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar;

ç) përfitim të financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;

d) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;

dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;

e) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;

ë) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

8. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 7, të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:

a) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti;

b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit dhe 2 (dy) referime

mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

9. Niveli sasior i treguesve, të përcaktuar në pikën 7 të këtij kreu, si dhe vlera përkatëse e tyre parashikohen në rregulloren përkatëse të IAL-ve dhe vendosen në funksion të prioriteteve akademike e strategjike të tyre. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtari të parashikuara në pikën 7 të këtij kreu, hartohet nga njësisia bazë e njësisia kryesore dhe miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.

10. Në rastet kur kandidati ka realizuar studim postdoktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, me një kohëzgjatje, të paktën, 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe, ai ekuivalentohet me 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti dhe 1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

11. Për fitimin e titullit akademik “profesor i asociuar”, botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së gradës shkencore “doktor”, deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik “profesor i asociuar”.

12. IAL-të përcaktojnë në rregulloret e tyre përkatëse kriteret për vlerësimin akademiko-didaktik të kandidatëve për fitimin e titujve akademikë.

KREU III

STANDARDET PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK “PROFESOR”

1. Titulli akademik “profesor” jepet nga institucionet e arsimit të lartë, të llojit “Universitet”, të cilat plotësojnë kriteret ligjore dhe ato të përcaktuara në këtë vendim.



2. Personeli akademik, i cili ka titullin akademik “profesor i asociuar”, aplikon për fitimin e titullit akademik “profesor”, të paktën, 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit akademik “profesor i asociuar”.

3. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik “profesor”, duhet:

a) të ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike;

b) të jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë si lektor për një periudhë 8-vjeçare (tetëvjeçare) akademike, pas fitimit të gradës shkencore “doktor”, ose me kohë të pjesshme, si lektor, për një periudhë 12-vjeçare (dymbëdhjetëvjeçare) akademike pas fitimit të gradës shkencore “doktor”;

c) të ketë udhëhequr, të paktën, 2 (dy) doktorata, të përfunduara. Në rast se kandidati ka ushtruar veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, në momentin e aplikimit të ketë udhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar;

ç) të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore-shkencore përpara Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik në një nga këto gjuhë, në përputhje me statutin dhe rregulloren e IAL-së.

4. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin “profesor”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon:

a) Ka botuar, së paku, 7 (shtatë) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore, brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 3 (tre) prej artikujve të jenë botuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga *Thomson Reuters* dhe/ose *Scopus*. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i parë në, të paktën, 4 (katër) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;

b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të

Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

5. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:

a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “profesor i asociuar” brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësi bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers*, në kategorinë A, B, C ose D. Monografite konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-ës;

b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:

i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;

ii) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:

i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;

ii) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

6. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik “profesor i asociuar”, në:

a) komitete shkencore apo redaktuese;

b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;

c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtare;



ç) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;

d) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;

dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;

e) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;

ë) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

7. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 5, të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:

a) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti;

b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, dhe 2 (dy) referime të mbajtura në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

8. Niveli sasior i treguesve të përcaktuar në pikën 6, të këtij kreu, si dhe vlera përkatëse e tyre parashikohen në rregulloren përkatëse të IAL-ve dhe vendosen në funksion të prioriteteve akademike e strategjike të tyre. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në pikën 6, të këtij kreu, hartohet nga njësia bazë e njësia kryesore dhe miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.

9. Për fitimin e titullit akademik “profesor”, botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së titullit akademik “profesor i asociuar” deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik “profesor”.

10. IAL-të, në rregulloret e tyre përkatëse, përcaktojnë kriteret për vlerësimin akademiko-didaktik të kandidatëve për fitimin e titujve akademikë.

KREU IV

PROCEDURAT PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

1. Kandidati paraqet kërkesën dhe dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për

vlerësim njësisë bazë brenda 20 (njëzet) ditëve. Pas vlerësimit nga njësia bazë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, dosja e kandidatit i përcillet Senatit Akademik, i cili, brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e dosjes, ia përcjell Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.

2. Nëse njësia bazë jep vlerësim negativ, dosja i kthehet drejtuesit të njësisë kryesore me argumentet dhe sugjerimet përkatëse. Kandidati ka të drejtë të aplikojë sërish, brenda një afati kohor prej 6 (gjashtë) muajsh. Vendimi i njësisë bazë merret nga shumica e anëtarëve të saj.

3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përcjelljes së dosjes nga Senati, Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik vlerëson nëse dosja e dorëzuar nga kandidati është e plotë apo jo. Në rast se dosja konsiderohet e plotë, Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik vijon menjëherë me ngritjen e jurisë për vlerësimin e dosjes. Në rast të evidentimit të mangësive në dosjen e kandidatit, atij i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë për të bërë plotësimet e nevojshme. Në rast se ato nuk plotësohen, dosja i kthehet kandidatit.

4. Data e nisjes së procedurës së vlerësimit të kandidatit konsiderohet data e ngritjes së jurisë.

5. Juria përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë me titullin akademik “profesor” të së njëjtës fushë ose fushave të ngjashme me atë të kandidatit, prej të cilëve, të paktën, 2 (dy) duhet të jenë të ftuar nga IAL të tjera, vendase ose të huaja. Anëtarët e jurisë propozohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, me miratimin e rektorit. Numri i anëtarëve të propozuar është jo më pak se 8 (tetë).

6. Brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e nisjes së procedurës së vlerësimit, juria përgatit raportin e vlerësimit të kapaciteteve akademiko-didaktike e shkencore të kandidatit, në përfundim të të cilit jepet edhe rekomandimi për dhënien ose jo të titullit akademik. Raporti i vlerësimit i përcillet Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.

7. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik merr vendim përfundimtar për miratimin ose refuzimin e kërkesës së kandidatit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas marrjes së raportit të vlerësimit nga juria.

8. Në rast refuzimi të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik, kandidatit i lind e drejta të



ripërsërisë kërkesën, pas një periudhe kohore jo më të shkurtër se 2 (dy) vite nga data e paraqitjes së kërkesës së mëparshme, pranë drejtuesit të njësisë kryesore.

9. Titulli akademik regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe në regjistrat përkatës të IAL-së. Titulli akademik lëshohet nga institucioni dhe nënshkruhet nga rektori.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

1. Institucioni i arsimit të lartë mund të akordojë titullin “*Doctor Honoris Causa*” për figura të shquara të shkencës e shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit, për kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit e të shkencës, si dhe në zhvillimin e vendit tonë në tërësi. Ky titull jepet me vendim të Senatit Akademik të institucionit, pasi merret pëlqimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Numri i titujve “*Doctor Honoris Causa*” që një IAL mund të akordojë, si rregull, nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) në vit.

2. Institucioni i arsimit të lartë, në rregulloren e brendshme, përcakton procedurën dhe kriteret për fitimin e titullit “*Professor Emeritus*” nga anëtarët e personelit akademik që mbajnë titullin “profesor”, pas daljes së tyre në pension, pasi merret pëlqimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin.

3. Lista e plotë e revistave shkencore, të botuara brenda vendit, botohet në muajin shkurt të çdo viti nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

4. Kandidatët e regjistruar në programet e studimit të ciklit të tretë, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, përmbushin kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në momentin e regjistrimit në programin e studimit të ciklit të tretë.

5. Kandidatët, të cilët kanë filluar procedurën për marrjen e gradës shkencore “doktor”, e përfundojnë atë sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në momentin e fillimit të procedurës.

6. Kandidatët, të cilët nuk kanë filluar procedurën e marrjes së gradës shkencore “doktor”, do të ndjekin procedurën e përcaktuar në këtë vendim.

7. Kandidatët, të cilët kanë filluar procedurën për marrjen e titujve akademikë dhe kanë kaluar

fazën e miratimit nga Këshilli i Profesorëve, e mbyllin procedurën për marrjen e titullit akademik sipas kriterëve të legjislacionit në fuqi në momentin e dorëzimit të dosjes në Këshillin e Profesorëve. Këta kandidatë ndjekin procedurat e përcaktuara në këtë vendim për fazën përfundimtare në Komisionin për Promovimin e Personelit Akademik.

8. Kriteret dhe procedurat për fitimin e gradës shkencore “doktor” dhe të titujve akademikë “profesor i asociuar” dhe “profesor”, për fushat akademike ushtarake, të policisë, të arteve dhe të sportit, rregullohen me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave.

9. Përgjashtimisht për vitin 2018, afati i përcaktuar në pikën 3, të këtij kreu, është muaji qershor 2018.

10. Vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 467, datë 18.7.2007, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik”, të ndryshuar, dhe nr. 864, datë 5.12.2007, “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “doktor”, të ndryshuar, shfuqizohen.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 114, datë 23.2.2018****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR EMËRIMIN, SHKARKIMIN DHE
SHPËRBLIMIN E KRYETARIT DHE TË
ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES
TË AGJENCISË KOMBËTARE
TË DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e këshillit drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën, me propozim të ministrit përkatës, sipas përbërjes së përcaktuar në pikën 2, të nenit 7, të ligjit nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

2. Ministri përgjegjës për diasporën emëron kryetar të këshillit drejtues njërin nga anëtarët e tij.

3. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues duhet të jenë drejtues të nivelit të lartë në ministri apo anëtarë të kabinetit të ministrit.

4. Kryetari dhe anëtari i këshillit drejtues shkarkohet para mbarimit të mandatit 4-vjeçar:

a) kur lirohet ose shkarkohet nga funksioni drejtues që ushtronte në ministrinë që përfaqëson;

b) me propozim të ministrit përkatës, për shkak të ndryshimit të misionit e të detyrave, që ai kryen në ministri;

c) kur neglizhon kryerjen e detyrave dhe pjesëmarrjen e rregullt në mbledhjet e këshillit drejtues.

5. Ministri përgjegjës për diasporën, 30 (tridhjetë) ditë para mbarimit të mandatit 4-vjeçar ose menjëherë pas shkarkimit të anëtarit, i kërkon ministrisë së përfaqësuar në këshillin drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës paraqitjen e emrit të kandidatit për anëtar të këtij këshilli.

6. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës shpërblehen sipas vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.

7. Ministrat përkatës dërgojnë propozimet për anëtarët e këshillit drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, brenda një afati 10-ditor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

8. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë